

PROTOKOLL PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT MËSIMOR NË INSTITUCIONET EDUKATIVE-ARSIMORE DHE AFTËSUESE (IEAA) NË REPUBLIKËN E KOSOVËS NË VITIN SHKOLLOR 2021/2022

ORGANIZIMI - Organizimi i procesit mësimor për vitin shkollor 2021/2022 është paraparë të bëhet me prani fizike dhe me orar të plotë mësimor me respektim të masave sipas protokollit COVID-19. Për rastet kur infrastruktura e IEAA (ka mungesë të hapësirës së mjaftueshme për të siguruar distancë prej së paku 1m në mes të nxënësve) ose kushtet epidemiologjike nuk e lejojnë që mësimi të zhvillohet me prani fizike dhe orar të plotë mësimi, mbasin në fuqi dhe zbatohen sipas rekomandimeve të autoriteteve përkatëse skenarët A, B, C si në vitin e kaluar shkollor (2020/2021).

Në rastet kur infrastruktura në IEAA lejon, mësimdhënësit inkurajohen të zhvillojnë mësimin në klasë me aq nxënës sa respektohen masat parandaluese të COVID-19 dhe distanca 1m në mes të nxënësve, derisa disa nxënës përcjellin mësimin në distancë (përmes kamerës nga një hapësirë tjetër brenda IEAA ose nga shtëpia) dhe me rotacion (p.sh., në një klasë me 30 nxënës dhe ku mësimdhënësi ka mundësi teknike, 24 nxënës përcjellin mësimin me prani fizike në klasë, ndërsa 6 nxënës të tjerë kyçen nga shtëpia).

PËRGJEGJËSITË DHE MONITORIMI - Procesi mësimor organizohet në komunikim dhe bashkëveprim të vazhdueshëm në mes të Task Forcave (TF) në nivel të IEAA, Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).

- TF në IEAA organizojnë klasat varësisht nga situata epidemiologjike, numri i nxënësve në klasë dhe hapësira që kanë në dispozicion, në bashkëveprim me TF në DKA.
- TF në IEAA vendosin për aplikimin e skenarëve përkatës, në bashkëveprim me TF në DKA.
- TF në IEAA raporton rregullisht në TF në DKA, ndërsa kjo e fundit raporton rregullisht në TF në MASHTI.

INFORMIMI - IEAA në ditën e parë të mësimit informojnë nxënësit/fëmijët dhe personelin arsimor për rregullat dhe masat për parandalim të COVID-19 sipas protokollit COVID-19.

- Ofrojnë informata mbi pandeminë dhe masat parandaluese që duhet të merren nga të gjithë akterët e përfshirë në organizimin e procesit mësimor.
- Sigurohen që materialet edukative-informuese janë të ekspozuara në vende të dukshme në të gjitha hapësirat shkollore apo edhe në Internet (p.sh. materialet të jenë të përfshira dhe të dukshme në profilin e IEAA nëpër mediat sociale, uebfaqet e IEAA, etj.).

ZBATIMI I MASAVE PARANDALUESE – Personeli i IEAA obligohet që rreptësisht të ta monitorojë respektimin e masave sipas protokollit COVID-19. IEAA caktojnë një person përgjegjës të rendit që do të koordinojë e monitorojë përfilljen e masave jashtë klasës.

Distanca - IEAA obligohen që në të gjitha hapësirat e tyre të respektohet kriteri sipas protokollit COVID-19 për distancë prej së paku 1m në mes të fëmijëve/nxënësve dhe personelit edukativ-arsimor dhe teknik.

- Hyrja dhe dalja në IEAA planifikohet sipas strukturës së objektit, në bashkëveprim me TF në IEAA.
- Në objektet me më shumë se një hyrje, planifikohet shfrytëzimi i të gjitha hyrjeve për qarkullim edhe të nxënësve.
- Në rastet kur ka vetëm një hyrje dhe numri i nxënësve është i madh, mund të planifikohet edhe fillimi i mësimit në orare të ndryshme, për një ndërrim.
- Në IP: Prindërit/kujdestarët ligjorë (apo personat e autorizuar nga familja) i sjellin dhe marrin fëmijët duke respektuar me përpikëri orarin e përcaktuar nga IP.

- Prindërve/kujdestarëve ligjorë dhe personave të paaautorizuar u ndalohet hyrja në hapësirat e IEAA. Në raste specifike, ku lejohet hyrja në shkollë (p.sh. për inspektim ose mirëmbajtje), duhet të ruhet distanca dhe të shmangët kontakti me nxënës/fëmijë.
- IEAA bënë një orar apo rend të caktuar në mënyrë që të sigurohet distanca gjatë ngrënies, pushimeve dhe rasteve të nevojshme të grumbullimit.
- Mësimdhënësit/edukatorët shmangin grumbullimet në hapësirat e IEAA përtej orarit të tyre të punës. Rekomandohet që punët administrative t'i kryejnë nga shtëpia dhe takimet t'i mbajnë në mënyrë elektronike për minimizim të kontaktit fizik.
- Mësimdhënësit/edukatorët e klasës janë të obliguar të bëjnë organizimin dhe mbikëqyrjen e aranzhimit të vendosjes/uljes së nxënësve në klasa dhe të sigurojnë që secili nxënës të ketë vendin e caktuar dhe të mos bëhet ndërrimi apo bashkimi i grupeve (po ashtu në IP).
- Mësimdhënësit/edukatorët obligohen të shmangin grumbullimin e fëmijëve/nxënësve në tualete. Shkuarja në tualete organizohet në mënyrë që të mbahet rendi dhe distanca.
- Kontaktet me prindër/kujdestarë ligjorë bëhen përmes mjeteve të komunikimit elektronik (telefon/email)/ apo në ambient të hapur, me distancë sipas rekomandimeve të IKSHPK.

Maskat - Mbajtja e maskave është e obligueshme për të gjithë personat që janë në IEAA (përveç fëmijët nën moshën 5 vjeç, fëmijët me aftësi të kufizuara/dëmtime intelektuale, dhe rastet kur me udhëzim të mjekut është rekomanduar mosmbajtja e maskës).

Dezinfektimi – IEAA obligohen të sigurojnë ajrosjen dhe dezinfektimin e rregullt të ambienteve të tyre dhe mirëmbajtjen e nyjave sanitare, sipas udhëzimeve të IKSHPK. IEAA-të:

- Mbajnë evidencë mbi dezinfektimin e hapësirave.
- Ajrosin klasat pas çdo ore të mësimi, së paku dy herë në ditë. Mundësisht dhe në përputhje me rregullat e sigurisë, dritaret mbahen të hapura gjatë gjithë kohës.
- Sigurohen që ka ujë të rrjedhshëm, sapun të lëngët, letra për tharjen e duarve dhe dezinfektues me përmbajtje alkooli 60% (në IP) dhe 70% (në nivelet e tjera).
- Nxënësit/fëmijët informohen mbi metodat e duhura të dezinfektimit të hapësirës që e frekuentojnë.
- Gjatë hyrjes dhe daljes në klasë dhe orarit të mësimi, mësimdhënësit/edukatorët kujdesen që nxënësit/fëmijët t'i dezinfektojnë duart.
- Pastrimi i sallave të ushqimit bëhet pas çdo përdorimi.
- Tualetet gjatë gjithë kohës janë funksionale dhe të furnizuara me ujë. Në rast të mungesës së ujit në tualete, IEAA obligohet të raportojë tek TF e DKA për të gjetur zgjidhje.

MENAXHIMI ME RASTET E DYSHUARA/KONFIRMUARA ME COVID-19 – IEAA planifikon dhe ndërmerr masat e nevojshme për izolimin dhe njoftimin për rastet e dyshuara/konfirmuara.

- Përcakton një hapësirë të veçantë për izolimin e rasteve që shfaqin simptoma të COVID-19. Në IP: fëmija duhet të izohet në shoqërim të edukatores/it në një hapësirë të veçantë dhe të kontaktohet menjëherë prindi/kujdestari ligjor.
- Drejtori/ja (ose një i/e deleguar nga ai/ajo për këtë përgjegjësi) lajmëron prindin/kujdestarin ligjor për rastin e dyshuar dhe IKSHPK për udhëzime të mëtejme.
- Sigurohet që të gjitha sipërfaqet që kanë qenë të frekuentuara nga të infektuarit/dyshuarit për infektim të dezinfektohen, sipas protokollit COVID-19.
- Drejtori/ja raporton mbi rastin dhe hapat e ndërmarra tek TF në DKA për evidentim dhe përcjelljen e situatës, si dhe e përditëson raportin varësisht si zhvillohet rasti.
- TF në IEAA në bashkëveprim me TF në DKA merr vendim për mënyrën e vazhdimi të mësimi sipas skemës përkatëse.

Gjurmimi i kontakteve në mjedisin e shkollës - Gjurmimi i kontakteve bëhet me qëllim të identifikimit të shpejtë dhe shmangies së shpërthimeve të mëdha dhe ndërprerjes së aktiviteteve shkollore. Gjurmimi i kontakteve kryhet në bashkëpunim të ngushtë në mes të autoriteteve lokale të shëndetit publik dhe atyre

të IEAA. Kontaktet duhet të menaxhohen në bazë të kategorisë së ekspozimit. *Kontakt i ngushtë* është personi që:

- Ka pasur kontakt ballë për ballë me rastin e konfirmuar COVID-19 në distancë prej 1 metër për 15 minuta gjatë 24 orëve. Nxënësi/fëmija brenda klasës nuk konsiderohet kontakt i afërt nëse është në distancë prej 1 m me rastin e konfirmuar me COVID-19 dhe të dy bartin maska.
- Ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë të pambrojtur me sekrecione infektive nga një rast i konfirmuar COVID-19 (për shembull, duke u kollitur);
- Ka udhëtuar së bashku me një rast të konfirmuar COVID-19 për më shumë se 15 minuta në distancë prej 1 m dhe nuk ka mbajtur maskën e rekomanduar.

Të gjitha kontaktet që shfaqin ose zhvillojnë simptoma gjatë gjurmimit testohen sa më shpejt. Kontaktet me rrezik të lartë në mjediset e IEAA vendosen në karantinë dhe përcillen në vazhdimësi nga IEAA ose autoritetet e shëndetit publik¹.

Informatat për rastet e konfirmuara të nxënësve/mësimdhënësve mlidhen dhe raportohen në baza ditore nga Inspektorati i Arsimit.

¹ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/COVID-19-in-children-and-the-role-of-school-settings-in-transmission-second-update.pdf>